<p>duke marrë pjesë në 60 orë trajnim brenda dy (2) vite të njëpasnjëshme, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 22 në këtë Ligj.</p> <p>2. Në rast të dyshimit për mashtrim gjatë auditimit, auditori i brendshëm njofton drejtorin e njësisë së auditimit të brendshëm, i cili menjëherë njofton udhëheqësin e subjektit të sektorit publik, ose autoritetet kompetente.</p> <p>3. Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm, përveç përgjegjësi të tij, është përgjegjës për:</p> <p>3.1. aktivitetet e përgjithshme të njësisë së auditimit të brendshëm;</p> <p>3.2. të vepruar në pajtueshmëri me standardet e auditimit të brendshëm dhe rregulloret e auditimit të brendshëm si dhe metodologjinë e miratuar nga Ministri i Financave;</p> <p>3.3. përgatitjen dhe dorëzimin e planit strategjik dhe planit vjetor për rishikim dhe miratim tek udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe te Komiteti i Auditimit, në ato subjekte ku është i themeluar ky Komitet;</p> <p>3.4. bashkërendimin e ndërveprimit me Njësinë Qendrore Harmonizuese dhe me institucionet e auditimit të jashtëm, para dorëzimit të regjistrave apo</p>	<p>in accordance with the criteria defined in Article 22 in this Law and attending 60 hours of training within two subsequent years.</p> <p>2. In case of suspicion of fraud in the course of audit, the internal auditor shall notify the Head of Internal Audit Unit, who shall immediately notify the Head of Public Sector Entity, or competent authorities.</p> <p>3. The Head of Internal Audit Unit, in addition to his responsibilities, shall be responsible for:</p> <p>3.1. the overall activities of the Internal Audit Unit;</p> <p>3.2. acting in compliance with the Internal Audit Standards and internal audit regulations and methodology issued by the Minister of Finance;</p> <p>3.3. draft and deliver strategic plan and annual plans for review and adoption to the Head of the Public Sector Entity and Audits Committee, on those subjects where the Committee is established;;</p> <p>3.4. coordination of the interaction with Central Harmonisation Unit and external audit institutions, prior to submitting records or reports to external</p>	<p>u obukama za osposobljavanje od 60 sati u roku od dve (2) uzastopne godine, u skladu sa utvrđenim kriterijumima iz člana 22. ovoga Zakona.</p> <p>2. U slučaju sumnje o prevari tokom revizije, unutrašnji revizor obaveštava direktora Jedinice za unutrašnju unutrašnju reviziju, koji odmah obavštava Rukovodioca subjekta u javnom sektoru, ili nadležna tela.</p> <p>3. Direktor Jedinice za unutrašnju unutrašnju reviziju, pored svojih odgovornosti, odgovoran je i za:</p> <p>3.1. opšte aktivnosti jedinice za unutrašnju unutrašnju reviziju;</p> <p>3.2. postupanje u skladu sa standardima unutrašnje revizije i propisima unutrašnje revizije i metodologije koju donosi Ministar finansija;</p> <p>3.3. priprema i dostavlja strateški plan i godišnji plan za pregled i usvajanje od rukovodioca subjekta javnog sektora i Komiteta revizije, u tim subjektima gde je i osnivan ovaj Komitet;</p> <p>3.4. koordinacija interakcije sa Centralnom jedinicom za harmonizaciju i institucijama spoljne revizije, pre podnošenja registra ili</p>
--	---	--

<p>raporteve palëve të jashtme, drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm merr aprovimin nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik;</p> <p>3.5.dërgimin e raporteve gjashtë (6) mujore dhe vjetore te Njësia Qendërore Harmonizuese më së largu deri më pasëmbëdhjetë (15) korrik të vitit, respektivisht deri më pasëmbëdhjetë (15) janar të vitit pasues.</p> <p>4. Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm i raporton udhëheqësit të subjektit të sektorit publik për të gjitha çështjet që i përkasin kryerjes së një auditimi të veçantë, dhe i propozon udhëheqësit të subjektit të sektorit publik që të angazhojë një ekspert të fushës, ku nevojiten aftësitë dhe shkathtësitë e veçanta që lidhen me kryerjen e auditimit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 26 Kufizimet në punën e auditorëve të brendshëm</p> <p>1. Auditorët e brendshëm në punën e tyre janë të paanshëm, objektiv dhe raportojnë për çfarëdo konflikti të mundshëm të interesit. Në lidhje me këtë auditorët e brendshëm:</p> <p>1.1. nuk përfshihen në realizimin e funksioneve të drejtpërdrejta të subjektit të sektorit publik;</p>	<p>parties, the Head of Internal Audit Unit shall obtain the approval of the Head of Public Sector Entity.</p> <p>3.5. submitting of six (6) monthly and annual reports to a Central Harmonisation Unit until the latest fifteen (15) July, and up to fifteen (15) January of the following year.</p> <p>4. Head of Internal Audit Unit shall report to the Head of Public Sector Entity on any matters regarding the performance of a particular audit, and shall propose to the Head of Public Sector Entity to appoint an expert of the respective area where special knowledge and skills related to performance of audit are needed.</p> <p style="text-align: center;">Article 26 Restrictions in the work of internal auditors</p> <p>1. The internal auditors in their work shall be impartial, objective and shall report on any potential conflicts of interest. With this regard, the internal auditors shall:</p> <p>1.1. not be involved in execution of direct functions of the Public Sector Entity;</p>	<p>izveštaja spoljnim strankama, direktor jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju dobija usvajanje od Rukovodioca subjekta javnog sektora.</p> <p>3.5 dostavljanje 6 (šesto) mesečnih i godišnjih izveštaja Centralnoj jedinici za harmonizaciju, naj kasnije do 15 (petnaestog) jula godine, odnosno, do 15 (petnaestog) januara naredne godine.</p> <p>4. Direktor Jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju izveštava Rukovodioca subjekta u javnom sektoru o svim pitanja koja se odnose na obavljanje posebne revizije i predlaže Rukovodiocu subjekta javnog sektora da angažuje stručnjake iz oblasti, gde se zahteva sposobnost i specifična veština vezane za sprovođenje revizije.</p> <p style="text-align: center;">Član 26 Ograničenja u radu unutrašnjimunutrašnjih revizora</p> <p>1. Unutarnji revizori u svom radu su nepristrani, objektivni i prijavljuju o svakom potencijalnom sukobu interesa. U vezi sa tim, unutarnji revizori:</p> <p>1.1. nisu obuhvaćeni u sprovođenju neposrednihfunkcija subjekta u javnom sektoru;</p>
---	---	--

<p>1.2. nuk mbajnë poste politike, nuk janë anëtarë aktivë të ndonjë subjekti politik dhe nuk emërohen në pozita drejtuese në strukturat e subjekteve politike; dhe</p> <p>1.3. nuk kryejnë angazhime auditimi për dhënien e sigurisë lidhur me funksionet, veprimtaritë dhe strukturat për të cilat ata kanë dhënë shërbime këshilluese ose në të cilat kanë qenë të punësuar gjatë periudhës së kaluar një (1) vjeçare.</p> <p style="text-align: center;">Neni 27 Konflikti i interesit</p> <p>1. Në rast të ndonjë konflikti aktual apo të mundshëm të interesit në përputhje me legjislacionin në fuqi që mund të paraqitet si rezultat i auditimit, auditori i brendshëm menjëherë njofton me shkrim drejtorin e njësisë së auditimit të brendshëm. Pas njoftimit për një konflikt të tillë, drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm e cakton auditorin e brendshëm në detyra të tjera, aty ku nuk ka konflikt të interesit.</p> <p>2. Konflikti i interesit, përveç rasteve të parashikuara në legjislacionin e përgjithshëm, ekziston nëse:</p> <p>2.1. auditori i brendshëm ka punuar</p>	<p>1.2 not hold a political mandate, not be active members of any political party and not be appointed in managerial positions in political party structures; and</p> <p>1.3 not perform audit engagements for providing assurance relating to functions, activities and structures on which he/she has provided consulting services or in which he/she has been employed over the past one year period.</p> <p style="text-align: center;">Article 27 Conflict of interest</p> <p>1. In case of any actual or potential conflict of interest in accordance with applicable legislation that may arise from an audit assignment, internal auditor shall immediately notify in writing the Head of Internal Audit Unit. Upon notification of such a conflict, the Head of Internal Audit Unit shall reassign the internal auditor to other duties where a conflict of interest does not arise.</p> <p>2. A conflict of interest, in addition to cases stipulated in general legislation, shall exist if:</p> <p>2.1 The internal auditor has worked</p>	<p>1.2. ne drže političke pozicije, nisu aktivni članovi niti jedne političke stranke, i ne imenjuju se na vodeće položaje u strukturama političkih stranaka, i</p> <p>1.3. ne izvode revizijske poslove za osiguranja u vezi funkcija, aktivnosti i struktura za koje su dali konsultantske usluge ili koji su bili zaposleni u proteklom periodu od jedne (1) godine.</p> <p style="text-align: center;">Član 27 Sukob interesa</p> <p>1. U slučaju bilo kakvog stvarnog ili potencijalnog sukoba interesa u skladu sa zakonodavstvom koje je na snazi koji može nastati kao rezultat revizije, unutrašnji revizor je dužan da odmah pismeno obavestiti, direktora jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju. Nakon obaveštavanja o takvom sukobu, direktor jedinice za unutrašnjuunutrašnju reviziju određuje tog unutrašnjeg revizora za druge poslove, tamo gde ne postoji sukob interesa.</p> <p>2. Sukob interesa, osim u slučaju predviđen opštim propisima, postoji ako je:</p> <p>2.1. je unutrašnji revizor: radio tokom</p>
---	--	---

<p>gjatë vitit të fundit për subjektin që do të auditohet dhe për të cilin ka përcaktuar, vendosur dhe hartuar procedurat për sistemet ose proceset që janë subjekt i auditimit brenda vitit të kaluar;</p> <p>2.2. në mesin e menaxhementit dhe zyrtarëve të lartë që përfshin auditimi, është personi me të cilin auditori i brendshëm ka pasur marrëdhënie afariste në vitin e fundit dhe/apo ka marrëdhënie familjare deri në brezin e dytë të familjes, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi; dhe</p> <p>2.3. ka rrethana të tjera që mund të çojnë në konflikt të mundshëm interesi, nëse ato janë të konsideruara si të tilla dhe nëse ato janë shpjeguar me shkrim nga drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm.</p>	<p>during the last year for the entity that will be audited and for which he designed, installed, drafted procedures for and operated the systems or processes that are subject of audit within the previous year;</p> <p>2.2 Among the management and senior officials that audit involves there is a person with whom the internal auditor has had business in the past year and/or any family relationship up to the second family generation, as defined in the legislation in force; and</p> <p>2.3 There are any other circumstances that may lead to potential conflict of interest, if they are considered as such and if they are explained in writing by the Head of Internal Audit Unit.</p>	<p>prošle godine za subjekat koji će biti revidiran i za kojeg je definiran, uspostavljen i razvijena procedura za sisteme i procese koji su predmet revizije prošle godine;</p> <p>2.2. među menadžmenta i visokih zvaničnika koje obuhvatra revizija, to je osoba s kojim je unutrašnji revizor: imao poslovne odnose u poslednjih godinu dana i / ili je član porodice do druge generacije porodice, kao što je definisano u zakonima na snazi, i</p> <p>2.3. postoje druge okolnosti koje bi mogle dovesti do potencijalnog sukoba interesa, ukoliko se one smatraju kao takve i ako su objašnjeni u pisanom obliku od strane direktora jedinice za unutrašnjunutrašnju reviziju.</p>
<p>KAPITULLI IV</p> <p>BASHKËRENDIMI DHE HARMONIZIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË FINANCIVE PUBLIKE</p> <p>Neni 28 Përgjegjësitë e Ministrit të Financave</p>	<p>CHAPTER IV</p> <p>COORDINATION AND HARMONIZATION OF PUBLIC INTERNAL FINANCIAL CONTROL</p> <p>Article 28 Responsibilities of the Minister of Finance</p>	<p>POGLAVLJE IV</p> <p>KOORDINACIJA I HARMONIZACIJA UNUTRAŠNJE KONTROLE JAVNIH FINANSIJA</p> <p>Član 28 Odgovornosti Ministra finansija</p>
<p>1. Ministri i Financave është përgjegjës</p>	<p>1. The Minister of Finance shall be</p>	<p>1. Ministar finansija je odgovoran za</p>

<p>për bashkërendimin dhe harmonizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike për të gjitha subjektet e sektorit publik, përfshirë:</p> <p>1.1. sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin;</p> <p>1.2. funksionin e pavarur të decentralizuar të auditimit të brendshëm; dhe</p> <p>1.3. funksionin qendror për harmonizimin dhe bashkërendimin e tyre.</p> <p>2. Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, Ministri i Financave është autoriteti përgjegjës për miratimin e akteve nënligjore dhe manualeve për:</p> <p>2.1. themelimin dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollin, në përputhje me standardet e kontrollit të brendshëm të njohura ndërkombëtarisht;</p> <p>2.2. përcaktimin e formatit, përmbajtjes dhe afateve për deklarimin vjetor dhe raportimin nga subjektet e sektorit publik për Ministrinë e Financave për cilësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin, parregullsitë e identifikuarra dhe masat e ndërmarra gjatë vitit paraprak;</p>	<p>responsible for establishing the coordination and harmonisation of the system of public internal financial control for all public sector entities, including:</p> <p>1.1. the financial management and control system;</p> <p>1.2. the independent decentralized function of the internal audit; and</p> <p>1.3. the central function for harmonizing and coordinating them.</p> <p>2. In the field of Financial Management and Control, the Minister of Finance shall be the responsible authority for the approval of sub-legal acts and manuals for:</p> <p>2.1. the set up and functioning of the Financial Management and Control systems, in accordance with the internationally acknowledged internal control standards;</p> <p>2.2. the format, content and deadlines for the annual declaration and reporting from public sector entity to the Ministry for Finance on the quality of the Financial Management and Control, identified irregularities and measures taken during the previous year;</p>	<p>koordinaciju i harmonizaciju sistema unutrašnje kontrole javnih financija za sve subjekte javnog sektora, uključujući:</p> <p>1.1. sistem finansijskog upravljanja i kontrole;</p> <p>1.2. nezavisne decentralizovane funkcije unutrašnje revizije, i</p> <p>1.3. Centralna funkcija za njihovo usklađivanje i koordinaciju.</p> <p>2. Iz oblast finansijskog upravljanja i kontrole, Ministar financija je odgovorni autoritet za usvajanje podzakonskih akata i priručnika za:</p> <p>2.1. uspostavu i funkcionisanje sistema finansijskog upravljanja i kontrole, u skladu sa međunarodno priznatim standardima unutrašnje kontrole;</p> <p>2.2. utvrđivanje formata, sadržaja i rokova za godišnju deklaraciju i izveštavanje subjekata u javnom sektoru za potrebe Ministarstva financija o kvalitetu finansijskog upravljanja i kontrole, nepravilnosti i poduzete mere utvrđene tokom prethodne godine;</p>
--	--	---

<p>2.3. monitorimin e cilësisë së sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</p> <p>3. Në fushën e auditimit të brendshëm, Ministri i Financave është përgjegjës për:</p> <p>3.1. themelimin, zhvillimin, bashkërendimin dhe monitorimin e zbatimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë;</p> <p>3.2. përgatitjen e kritereve për themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik dhe propozimin për nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse;</p> <p>3.3. miratimin e politikave, akteve nënligjore, doracakëve, procedurave për auditimin e brendshëm dhe harmonizimin e tyre me standardet ndërkombëtare për auditimin e brendshëm;</p> <p>3.4. kriteret dhe kërkesat për certifikim të auditorëve të brendshëm në sektorin publik.</p> <p>4. Ministri i Financave prezanton në Qeveri raportin e konsoliduar vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm financiar publik, pas konsultimit me Këshillin e KBFP-së, deri në fund të muajit qershor të vitit aktual, për vitin e kaluar.</p>	<p>2.3. monitoring of the quality of the Financial Management and Control systems.</p> <p>3. In the field of internal audit, the Minister of Finance shall be responsible for:</p> <p>3.1. establishing, developing, coordinating and monitoring the implementation of internal audit in the public sector of Kosovo;</p> <p>3.2. determining the criteria for the establishment of Internal Audit function in the public sector and proposing to issue the respective sub-legal acts;</p> <p>3.3. approving policies, sublegal acts, manuals, procedures on Internal Audit and their harmonization with the international standards on Internal Audit;</p> <p>3.4. criteria and requirements for certification of the public sector internal auditors.</p> <p>4. The Minister of Finance shall present to the Government the Consolidated Annual Report on the Public Internal Financial Control system, after consultation of the PIFC Council, by the end of the month of June of the current year, for the previous year.</p>	<p>2.3. praćenje kvaliteta sistema financijskog upravljanja i kontrole.</p> <p>3. Na području unutrašnje revizije, Ministar financija je odgovoran za:</p> <p>3.1. osnivanje, razvijanje, koordiniranje i praćenje sprovođenja unutrašnje revizije u javnom sektoru na Kosovu;</p> <p>3.2. priprema kriterijuma za osnivanje funkcije unutrašnje revizije u javnom sektoru i predlaganje za izdavanje odgovarajućih podzakonskih akata;</p> <p>3.3. usvajanje politika, podzakonski akata, priručnika, postupaka za unutrašnju unutrašnju reviziju i njihovo usklađivanje s međunarodnim standardima za unutrašnju unutrašnju reviziju;</p> <p>3.4. kriterijume i zahteve za sertifikaciju unutrašnjim unutrašnjih revizora u javnom sektoru.</p> <p>4. Ministar finansija dostavlja Vladi konsolidirani godišnji izveštaj o sistemu za kontrolu javnih finansija, nakon savetovanja sa Svetom CJH do kraja meseca juna tekuće godine, za proteklu godinu.</p>
---	---	--

5. Për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuar në këtë nen, Ministri i Financave përkrahet nga Njësia Qendrore Harmonizuese si dhe nga Këshilli i KBFP-së.

**Neni 29
Këshilli i KBFP-së**

1. Këshilli i Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (Këshilli i KBFP-së) është trup këshillëdhënës për subjektet e sektorit publik dhe themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. Këshilli i KBFP-së përbëhet nga anëtarët në vijim:

2.1. Ministri i Ministrisë së Financave, kryesues;

2.2. Ministri i Ministrisë së Administratës Publike, anëtar;

2.3. Zëvendësministri i Ministrisë së Financave, anëtar;

2.4. Njëri nga përfaqësuesit e Komisionit të Granteve nga niveli lokal;

2.5. Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, anëtar;

2.6. Drejtori i Departamentit të

5. To exercise the responsibilities set out under this Article, the Minister of Finance shall be supported by the Central Harmonisation Unit as well as by the PIFC Council.

**Article 29
The PIFC Council**

1. The Public Internal Financial Control Council (PIFC Council) is an advisory body for public sector entities and shall be established by the Government of the Republic of Kosovo.

2. The PIFC Council shall consist of the following members:

2.1. Minister of the Ministry of Finance - chair;

2.2. Minister of the Ministry of Public Administration – member;

2.3. Deputy Minister of the Ministry of Finance – member;

2.4. One of the representative of the Local Level Grants Commission;

2.5. Head of the Public Procurement Regulatory Committee; member;

2.6. Head of the Treasury Department,

5. Da bi preduzeo određene odgovornosti navedene u ovom članu, Ministar finansija će imati podršku Centralne jedinice za harmonizaciju i od Saveta UKJF.

**Član 29
Savet UKJF**

1. Savet za unutrašnju kontrolu javnih finansija (Savet UKJF) je savetodavno telo za subjekte javnog sektora i osniva se od Vlade Republike Kosovo.

2. Savet UKJF se sastoji od sledećih članova:

2.1. Ministra finansija, predsedavajući;

2.2. Ministra javne uprave, član;

2.3. Zamenik ministra finansija, član;

2.4. Jedan od predstavnika Komisije za garantove na lokalnom nivou, član;

2.6. Predsednika regulativne komisije za javnu nakabu, član;

2.6. Direktora Odeljenja Trezora, član;

<p>Thesarit, anëtar;</p> <p>2.7. Drejtori i Departamentit të Buxhetit, anëtar;</p> <p>2.8. Drejtori i Njesisë Qendrore Harmonizuese, anëtar; dhe</p> <p>2.9. Një përfaqësues nga Ndërmarrjet Publike, anëtar.</p> <p>3. Një përfaqësues nga Zyra Kombëtare e Auditorit të Përgjithshëm merr pjesë në punimet e KBFP-së në cilësinë e vëzhguesit.</p> <p>4. Këshilli i KBFP-së ofron rekomandime për subjektet e sektorit publik për përmirësimet e proceseve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe rregullimeve për menaxhimin e burimeve publike në subjektet e sektorit publik, dhe propozon veprime që kërkojnë miratim nga Qeveria.</p> <p>5. Këshilli për KBFP takohet së paku dy herë në vit dhe Njësia Qendrore Harmonizuese vepron si sekretariat për Këshillin e KBFP-së.</p>	<p>member;</p> <p>2.7. Head of the Budget Department, member;</p> <p>2.8. Head of the Central Harmonisation Unit, member; and</p> <p>2.9. A representative from Publicly Owned Enterprises, member.</p> <p>3. A representative from the National Office of the Auditor General shall participate in the proceedings of PIFC in an observer capacity.</p> <p>4. The PIFC Council shall provide recommendations to the Public Sector Entities for improving the Financial Management and Control processes and on regulations concerning management of public resources across the Public Sector Entities and propose actions requiring the endorsement of the Government.</p> <p>5. The PIFC Council shall meet at least twice a year and the Central Harmonisation Unit shall act as the secretariat for the PIFC Council.</p>	<p>2.7. Direktora Odeljenja za budžet, član;</p> <p>2.8. Direktora Centralne jedinice za harmonizaciju, član; i</p> <p>2.9. Jedanog predstavnika iz javnih preduzeća; član.</p> <p>3. Jedan predstavnik iz Nacionalne kancelarije Generalnog revizora je pozvan kao promatrač.</p> <p>4. Savet UKJF- nudi preporuke za subjekte javnog sektora za poboljšanja u procesima finansijskog upravljanja i kontrole i postupcima za upravljanje javnim resursima u subjektima javnog sektora i predlaže mere potrebne za suglasnost od Vlade.</p> <p>5. Savet UKJF se sastaje najmanje dva puta godišnje, a Centralna jedinica za harmonizaciju djeluje kao sekretarijat Saveta UKJF.</p>
---	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 30 Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Auditim të Brendshëm</p> <p>1. Ministri i Financave në përmbushjen e detyrave të tij sipas nenit 28 të këtij Ligji, përkrahet nga Njësia Qendrore Harmonizuese, e cila është themeluar si departament i veçantë në Ministrinë e Financave dhe i raporton drejtpërdrejt Ministrit të Financave.</p> <p>2. Drejtori dhe stafi i Njesisë Qendrore Harmonizuese janë shërbyes civil dhe emërohen sipas legjislacionit përkatës për emërimin e shërbyesve civil.</p> <p>3. Njësia Qendrore Harmonizuese është përgjegjëse për:</p> <p>3.1. zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe dokumenteve strategjike për zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, dhe auditimin e brendshëm, në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht dhe me praktikatat e mira të BE-së;</p> <p>3.2. hartimin e legjislacionit primar dhe akteve nënligjore, doracakëve, udhëzuesve dhe metodologjisë për menaxhimin financiar dhe kontrollin,</p>	<p style="text-align: center;">Article 30 Central Harmonisation Unit for Financial Management and Control and Internal Audit</p> <p>1. The Minister of Finance in fulfilment of his/her tasks under the Article 28 of this Law shall be supported by the Central Harmonisation Unit, which is established as a special Department in the Ministry of Finance and is directly accountable to the Minister of Finance.</p> <p>The director and a central Harmonization Unit staff are civil servants and are appointed under the respective legjislacionit for the appointment of civil servants.</p> <p>3. The Central Harmonisation Unit shall be responsible for:</p> <p>3.1. developing and implementing policies and strategic documents for development of financial management and control, and internal audit in accordance with internationally accepted standards and good EU practices;</p> <p>3.2. developing primary legislation and sub-legal acts, manuals, guidelines and methodology for financial management and control, and internal audit;</p>	<p style="text-align: center;">Član 30 Centralna jedinica za harmonizaciju za finansijsko upravljanje i kontrolu i unutrašnju reviziju</p> <p>1. Ministar finansija u ispunjavanju svojih dužnosti na osnovu člana 28 ovog Zakona je podržan od Centralne jedinice za harmonizaciju, koja je osnovana kao posebno odeljenje u Ministarstvu finansija i izveštava direktno Ministra finansija.</p> <p>2. CJH je rukovođena od direktora koji je državni službenik imenovan prema relevantnom zakonodavstvu, za imenovanje državnih službenika.</p> <p>3. Centralna jedinica za harmonizaciju je odgovorna za:</p> <p>3.1. razvoj i sprovođenje politika i strateških dokumenata za razvoj finansijskog upravljanja i kontrole i unutrašnje revizije, u skladu sa međunarodno priznatim standardima i najboljim praksama EU;</p> <p>3.2. izrada primarnog zakonodavstva i drugih propisa, priručnika, uputa i metodologija za finansijsko upravljanje i kontrole i unutrašnje revizije;</p>
--	---	---

<p>dhe auditimin e brendshëm;</p> <p>3.3. hartimin e programeve të trajnimit në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe organizimin e trajnimeve;</p> <p>3.4. hartimin dhe administrimin e politikave kombëtare për trajnimin, certifikimin dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional të auditorëve të brendshëm, sipas praktikave ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm; si dhe për organizimin e trajnimeve;</p> <p>3.5. ofrimin e konsultimeve për menaxherët dhe auditorët e brendshëm të subjekteve të sektorit publik në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditimin e brendshëm;</p> <p>3.6 monitorimin dhe vlerësimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit me qëllim të mbledhjes së informatave për të përmirësuar kornizën ligjore dhe metodologjinë;</p> <p>3.7. hartimin dhe zbatimin e metodologjisë së sigurisë së cilësisë për auditimin e brendshëm;</p> <p>3.8. monitorimin dhe kontrollin e cilësisë, ku Njësisë Qendrore të Harmonizimit duhet t'i sigurohet qasja në të gjitha dokumentet e nevojshme të subjekteve publike;</p>	<p>3.3. developing the training programs in the field of financial management and control, and organizing the trainings;</p> <p>3.4. developing and administering the national policies on the certification and continuous professional development training of internal auditors, based on the international practices in internal audit field and organising the training;</p> <p>3.5. providing Public Sector Entity managers and internal auditors with consultations in the field of financial management and control, and internal audit;</p> <p>3.6. monitoring and evaluating the Financial Management and Control systems for the purpose of gathering information to improve the legal framework and methodology;</p> <p>3.7. developing and implementing the quality assurance methodology for internal audit;</p> <p>3.8. for the purpose of monitoring and quality assurance, where the Central Harmonisation Unit shall have full access to all relevant sources of information in the Public Sector</p>	<p>3.3. Izrada programa obuke u području financijskog upravljanja i kontrole i organizacije obuka.</p> <p>3.4. izrada i upravljanje nacionalnih politika za obuke, sertifikaciju i kontinuirani stručni razvoj usavršavanja unutrašnjim unutrašnjih revizora u skladu sa međunarodnim praksama u području unutrašnje revizije za organizaciju obuke;</p> <p>3.5. pružanje konsultacija za unutrašnje rukovodilace revizore subjekata u javnom sektoru u području financijskog upravljanja i kontrole te unutrašnje revizije;</p> <p>3.6 praćenje i procena sistema financijskog upravljanja i kontrole radi prikupljanja informacija za poboljšanje pravnog okvira i metodologije;</p> <p>3.7. izrada i implementacija metodologije osiguranja kvaliteta za unutrašnju reviziju;</p> <p>3.8. praćenje i kontrolu kvaliteta, Centralnoj jedinici za harmonizaciju se mora osigurati pristup svim potrebnim dokumentima javnih subjekata.</p>
--	---	---

<p>3.9. themelimin dhe mbajtjen e regjistrit për auditorët e brendshëm të certifikuar, njësitë e auditimit të brendshëm, planet e auditimit të brendshëm dhe të dhënat tjera relevante;</p> <p>3.10. përgatitjen e Raportit të konsoliduar vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik në subjektet e sektorit publik në bazë të raporteve vjetore të pranuar nga subjektet e sektorit publik si dhe në bazë të rezultateve të monitorimit; dhe</p> <p>3.11. bashkëpunimin me institucionet brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës lidhur me sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm, dhe për ndarjen informatave në lidhje me zhvillimin e këtyre fushave në sektorin publik të Kosovës.</p> <p>4. Drejtori i Njësisë Qendrore Harmonizuese i dorëzon draft strategjitë, dokumentet e politikave, aktet nënligjore, programet e trajnimit dhe, udhëzuesit e metodologjisë të Ministri i Financave për miratim.</p> <p>5. Bashkëpunimi në mes të Ministrisë së Financave dhe subjekteve të tjera që ofrojnë trajnim rregullohet me</p>	<p>Entities;</p> <p>3.9. establishing and maintaining the register of certified internal auditors, internal audit units, internal audit charters and other relevant data;</p> <p>3.10. preparing the Annual Consolidated Report on Functioning of the Public Internal Financial Control system in the Public Sector Entities on the basis of annual reports received from the Public Sector Entities and based on results of monitoring activities; and</p> <p>3.11. cooperating with the institutions related to system of financial management and control, internal and external audit inside and outside of the Republic of Kosovo and for sharing information concerning the developments of these areas in the public sector of Kosovo.</p> <p>4. The Head of the Central Harmonisation Unit shall submit draft strategies, policy papers, sub-legal acts, training programmes and methodology guidelines and instructions to the Minister of Finance for approval.</p> <p>5. The cooperation between the Ministry of Finance and other entities providing training shall be regulated by a</p>	<p>3.9. osnivanje i održavanje registra sertifikovanih unutrašnjih revizora, jedinice unutarne jedinice, planove unutrašnje revizije i drugih relevantnih podataka;</p> <p>3.10. priprema Konsolidovanog godišnjeg izveštaja za funkcionisanje sistema unutrašnje finansijske kontrole u subjektima javnog sektora na osnovu primljenih godišnjih izveštaja od subjekata u javnom sektoru, kao i rezultate praćenja, i</p> <p>3.11. saradnja sa institucijama unutar i van Republike Kosova u vezi sa finansijskim upravljanjem i kontrolu, unutrašnje i spoljne revizije, i deli informacije o vezi sa razvojem tih područja u javnom sektoru Kosova.</p> <p>4. Direktor Centralne jedinice za harmonizaciju podnosi nacrt strategije, dokumenata politike, podzakonske aktove, programe obuke i upute metodologije kod Ministra finansija na usvajanje.</p> <p>5. Saradnja između Ministarstva finansija i drugih subjekata koji pružaju obuku, regulišu Sporazumom o saradnji.</p>
---	---	---

<p>Marrëveshje për Bashkëpunim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Marrëdhënia me Zyrën Kombëtare të Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës</p> <p>Njësia Qendrore Harmonizuese bashkëpunon me Zyrën Kombëtare të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës në mënyrë që të zhvilloj marrëdhëniet dhe bashkëpunimin në fushën e këmbimit të informatave dhe raporteve të auditimit dhe trajnimeve të përbashkëta dhe zhvillimit të metodologjive të auditimit.</p>	<p>Cooperation Agreement.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Relation with National Office of the Auditor General of the Republic of Kosovo</p> <p>The Central Harmonisation Unit shall cooperate with the National Office of the Auditor General of Kosovo in order to develop relations and cooperation in the area of exchange of information, audit reports and joint trainings, and development of audit methodologies.</p>	<p style="text-align: center;">Član 31 Odnos sa Nacionalnom kancelarijom generalnog revizora Republike Kosovo</p> <p>Centralna Jedinica za Harmonizaciju saraduje sa Nacionalnom kancelarijom Generalnog revizora Kosova kako bi se razvili odnosi i saradnja u cilju razmene informacija i revizijskih izvještaja i zajedničkih obuka i razvoja revizijskih metodologija.</p>
<p>KAPITULLI V</p> <p>RAPORTIMI PËR PARREGULLSITË</p>	<p>CHAPTER V</p> <p>REPORTING ON IRREGULARITIES</p>	<p>POGLAVLJE V</p> <p>IZVEŠTAVANJE O NEPRAVILNOSTIMA</p>
<p style="text-align: center;">Neni 32 Procedura për raportimin e parregullsive</p> <p>1. Udhëheqësi i subjektit të sektorit publik krijon sistemin për parandalimin e rrezikut për parregullsi dhe mashtrim, dhe ndërmerr veprime kundër parregullsive dhe mashtrimeve.</p> <p>2. Çdo punonjës, përfshirë edhe auditorët e brendshëm, informon për çdo parregullsi ose mashtrim të mundshëm, udhëheqësin e subjektit të sektorit publik dhe, nëse e</p>	<p style="text-align: center;">Article 32 Procedures for Reporting the Irregularities</p> <p>1. The Head of the public sector entity shall be obliged to establish the system for preventing the risk of irregularities and frauds and undertake activities against irregularities and frauds.</p> <p>2. All employees, including the internal auditors shall inform the Head of the public sector entity about any potential irregularity or frauds and if he/she</p>	<p style="text-align: center;">Član 32 Procedure o izveštavanju nepravilnosti</p> <p>1. Rukovodilac subjekta javnog sektora stvara sistem za sprečavanje rizika nepravilnosti i prevare, i poduzima mere protiv nepravilnosti i prevara.</p> <p>2. Svaki zaposleni, uključujući i unutrašnje revizore, obaveštava o bilo kakvim nepravilnostima ili mogućoj prevari, rukovodioca subjekta javnog sektora i</p>

<p>konsideron të dobishme, organet kompetente.</p> <p>3. Pas pranimit të raportit për ekzistimin e parregullsive, mashtrimeve dhe korrupsionit, udhëheqësi i subjektit të sektorit, ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe informon organet kompetente.</p> <p>4. Personi raportues dhe auditori i brendshëm nuk dëmtohet nga efektet paragjyquese nga ana e organizatës, si rezultat i komunikimit të informacionit të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, me kusht që të kenë vepruar në mënyrë të arsyeshme dhe me ndershmëri.</p>	<p>considers it useful, the competent bodies.</p> <p>3. Upon the receipt of the report on existence of irregularities, frauds and corruption, the Head of public sector entity shall undertake all necessary measures and shall inform competent bodies.</p> <p>4. The reporting person and internal auditor shall not be damaged by any prejudicial effects on the part of the organization as a result of having communicated the information stipulated in paragraph 2 of this article, provided that he has acted reasonably and honestly.</p>	<p>ukoliko smatra korisnim i nadležne organe.</p> <p>3. Po prijemu izveštaja o postojanju nepravilnosti, prevarama i korupciji, rukovodilac subjekta javnog sektora poduzima sve potrebne mere i obaveštava nadležne organe.</p> <p>4. Izvestioc i unutrašnji revizor:se ne oštećuju od efekta predrasuda od strane organizacije, kao rezultat komunikacije informacije spomenutog iz stavom 2 ovog člama., uz uslovom da su delovali razumno i pošteno.</p>
<p>KAPITULLI VI</p> <p>DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE TRANZITORE</p> <p>Neni 33 Dispozitat kalimtare</p>	<p>CHAPTER VI</p> <p>TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</p> <p>Article 33 Transitional Provisions</p>	<p>POGLAVLJE VI</p> <p>ZAVRŠNE I PRELAZNE ODREDBE</p> <p>Član 33 Prelazne odredbe</p>
<p>1. Ligjet dhe aktet nënligjore ekzistuese që prekën nga ky Ligj do të zbatohen me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë Ligj dhe deri në ndryshimin e tyre, por jo më vonë se dy (2) vite pasi ky ligj të ketë hyrë në fuqi.</p> <p>2. Emërimi dhe roli i Zyrtarit kryesor financiar, i përcaktuara me nenin 7 të këtij</p>	<p>1. Existing laws and sub-legal acts affected by this Law shall be implemented to the extent they comply with this Law up to their amendment, but in any case, not longer than two (2) years after this Law enters into force.</p> <p>2. The appointment and the role of Chief Financial Officer, defined by Article 7, of</p>	<p>1. Zakoni i postojeci podzakonski akti ovim zakonom će se primniti pod uslovom da nisu u suprotnosti s ovim Zakonom i do njihove izmene, ali ne kasnije od dve (2) godine po stupanju na snagu tog Zakona.</p> <p>2. Imenovanje i uloga Glavnog finansijskog direktora, utvrđena u članu</p>

<p>ligji, duhet të rishikohen nga të gjitha subjektet publike në pajtueshmëri me kërkesat e këtij Ligji dhe të monitorohen nga Njësia Qendërore Harmonizuese, por jo më vonë se dy (2) vite pasi ky ligj të ketë hyrë në fuqi.</p> <p>3. Përjashtimisht nga paragrafi 1.1. i nenit 34, pagat e auditorëve të brendshëm rregullohen me Ligjin Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm.</p>	<p>this article shall be reviewed by all public sector entities in compliance with the requirements of this Law and monitored by the Central Harmonization Unit, but in any case, not longer than two (2) years after this Law enters into force.</p> <p>3. Notwithstanding paragraph 1.1. Article 34, the salaries of internal auditors are regulated by Law no. 03 / L-128 on Internal Audit.</p>	<p>7.ovog Zakona, trebaju se pregledati od svih javnog subjekta u skladu sa zahtevima ovog zakona i nadgledani od CJH Ministarstva finansija, ali najkasnije u roku od dve (2) godine od stupnja na snagu ovog zakona. .</p> <p>3. Izuzetno od stava 1.1. Član 34, plate unutrašnjih revizora regulisane su Zakonom br. 03 / L-128 o internoj reviziji.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 34 Dispozitat shfuqizuese</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Abrogation Provisions</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Ukidajuće odredabe</p>
<p>1. Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji, shfuqizohen:</p> <p>1.1. Ligji Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm;</p> <p>1.2. Neni 6, paragrafi 2 dhe neni 10, paragrafi 2 (a) Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin nr. 04/L-194 dhe me Ligjin Nr. 05/L-063;</p> <p>1.3. Neni 38, paragrafi 2, i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike;</p> <p>1.4. Shprehja “të çështjeve financiare” te neni 40, paragrafi 4, i Ligjit Nr. 03/L-</p>	<p>1. Upon the entry of this Law into force, the following shall be abrogated:</p> <p>1.1. Law No. 03/L-128 on Internal Audit;</p> <p>1.2. Article 6, paragraph 2, and Article 10 paragraph 2 (a) of the Law No. 03/L-048 on Public Financial Management and Accountability, amended and supplemented by Law No. 03/L-221, Law No. 04/L-116, Law no. 04/L-194 and Law no. 05/L-063;</p> <p>1.3. Article 38, paragraph 2 of the Law No. 03/L-087 on Publicly Owned Enterprises;</p> <p>1.4. Expression “Financial issues” in Article 40, paragraph 4 of the Law No.</p>	<p>1. Stupanjem na snagu ovoga Zakona prestaju važiti:</p> <p>1.1. Zakon br. 03/L-128 za unutrašnjureviziju;</p> <p>1.2. Član 6. stav 2. i člana 10. stav 2. (a) Zakona br. 03 / L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornosti, dopunjen i izmenjen Zakonom br. 03 / L-221, Zakonom br. 04 / L-116, sa Zakonom br. 04 / L-194 i sa Zakonom br. 05 /L-063;</p> <p>1.3. Član 38. stav 2. Zakona br. 03 / L-087 o javnim preduzećima;</p> <p>1.4. Pojam "finansijska pitanja" u članu 40. stava 4. Zakona br. 03 / L-189 o</p>

<p>189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 35 Nxjerrja e akteve nënligjore</p> <p>Aktet nënligjore për zbatimin e këtij Ligji nxirren brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja e këtij Ligji në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Hyrja në fuqi</p> <p>Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <p style="text-align: center;">_____ Kryetar i Kuvendit i Republikës së Kosovës</p>	<p>03/L-189 on State Administration of the Republic of Kosovo;</p> <p style="text-align: center;">Article 35 Issuance of Sub-legal Acts</p> <p>The sub-legal acts for the implementation of this Law shall be issued within six (6) months from the entry of this Law into force.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Entry into force</p> <p>This Law shall enter into force fifteen (15) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <p style="text-align: center;">_____ The President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p>državnoj upravi Republike Kosova.</p> <p style="text-align: center;">Član 35 Donošenje podzakonskih akata</p> <p>Podzakonski aktovi za sprovođenje ovog Zakona se izrađuju u roku od šest (6) meseci od dana stupanja na snagu ovog Zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Stupanje na snagu</p> <p>Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom glasniku Republike Kosovo.</p> <p style="text-align: right;">Kadri Veseli</p> <p style="text-align: center;">_____ Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>
---	--	--